



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 2822 Prot.

Tiranë, më 04/12/2012

Lënda: <sup>12</sup> Rekomandim për kontrolluesin "BAITS" sh.p.k.

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 04/12/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Baits" sh.p.k.

KONSTATOVA

Më datë 06/11/2012, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, "Baits" sh.p.k, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

**1. Objekti i kontrollit:**

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të marketingut dhe shërbimeve me sms për votime, komente, opinione dhe sondazhe bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.**

Nga grupi i inspektimit u konstatua se kontrolluesi " Baits" sh.p.k nuk dispononte një database numrash celularë për ofrimin e shërbimit me SMS për votime, komente, opinione dhe sondazhe të ndryshme.

Aktualisht ky kontrollues nuk kishte filluar aktivitetin e tij dhe nuk ishte lidhur asnjë kontratë me asnjë nga operatorët celularë. Për të provuar këtë gjë nga kontrolluesi u paraqitën në cilësinë e provës edhe Faturat tatimore (Blloqe TVSH), të cilat në Drejtorinë e Tatimeve merren vetëm me autorizimin e administratorit të firmës, nga ku provohej që ky kontrollues nuk kishte filluar një aktivitet zyrtarisht.

Pavarësisht nga sa më sipër, mënyra se si do të operonte ky kontrollues në praktikë për ofrimin e këtij lloj shërbimi nuk i krijonte mundësinë për të patur akses në numrat celular në mënyrë të tillë që të mund të identifikonte subjektin e të dhënave personale.

Nga pikëpamja teknike shërbimi ofrohej si më poshtë vijon:

Nga shërbimet që do të ofrojë kompania BAIITS (Business Assistance Integrating Telecom Solutions) është Shërbimi SMS - <http://ëëë.baits.al/article/sms-services>  
Mënyra e funksionimit të këtij sistemi është e tillë:

Baits disponon platformën teknike që i bën të mundur kompanive të interesuara të realizojnë shërbime SMS të ndryshme, psh. sondazhe. Për të realizuar këtë Baits do të përdorë numrat 50020, 50040, 50120 sipas licensave të marra nga AKEP. Teknikisht ky proces mund të realizohet përmes përdorimit të aplikacioneve të tillë si *noësms* apo *kannel (open source SMS Gateway)*.

Pala e interesuar mund të ngarkojë përmes një ndërfaqeje ëeb listën e numrave ku do dërgohet mesazhi. Kjo listë nuk disponohet nga BAIITS, por pas përfundimit të operacionit në log-et e sistemit gjenden dhe numrat ku është dërguar mesazhi. Kompania mund ti përdorë këto log-e për ti dërguar informacion statistikor vetëm palës kontraktuese të këtij shërbimi (psh. % e mesazheve të mbritura në destinacion).

Megjithatë egziston risku që këta numra si të dhëna personale të keqpërdoren. Përhapja apo shitja e këtyre numrave, pavarësisht se nuk e identifikojnë personin, konsiderohet shkelje në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe për ligjet e telekomunikacionit, ky organ mbikqyrës është AKEP-i.

**Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast, si dhe provat e administruara vëren se:**

Duke patur parasysh që, pas përfundimit të operacionit në log-et e sistemit gjenden dhe numrat ku është dërguar mesazhi, ligjërisht vlerësojmë se në momentin e hartimit të kontratave për ofrimin e shërbimeve sms me operatorët e telefonisë celulare duhet të parashikohen rregulla konkrete në këto kontrata në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë e të dhënave dhe konfidencialitetin, sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

1. Kontrolluesi, “Baits” sh.p.k në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në momentin e fillimit të aktivitetit me operatorët e telefonisë celulare për ofrimin e shërbimit SMS, për votime, komente opinione dhe sondazhe të ndryshme të hartojë kontrata midis palëve ku të përcaktohen në mënyrë të qartë:
  - ✚ cili ka akses në të dhënat personale (numrat e telefonit, emrat e subjekteve të të dhënave personale);
  - ✚ cila është pala në kontratë që administron database-in e numrave celularë;
  - ✚ kohën e mbajtjes (ruajtjes) së database-it me numrat celular të subjekteve të të dhënave, pas përfundimit të shërbimit nga kontrolluesi.
2. Me plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

